

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8 – 36



Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Ortakët e Shoqërisë Conad Food Trade sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Conad Food Trade sh.p.k** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID-19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për pergatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

27 korrik 2021

mazars
Emin Duraku Str. Binjakët Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006V

Irena Hoxha (Pulo)

Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	6	167,189,637	201,438,080
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	-	871,818
Aktive me të drejtë përdorimi	8	373,167,854	391,289,206
Aktive afatgjatë materiale të investuara	8	17,989,976	23,255,304
Parapagime afatgjatë	9	12,096,177	12,096,177
Investime në ambiente të marra me qira	10	42,737,022	59,220,482
Totali i aktiveve afatgjatë		613,180,666	688,171,067
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	11	261,658,122	251,877,061
Llogari të arkëtueshme tregtare	12	20,979,060	20,899,361
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	13	87,384,291	40,493,136
Llogari të arkëtueshme të tjera	14	22,213,493	11,603,629
Tatim fitimi parapaguar	34	-	385,701
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	15	8,046,136	5,774,809
Mjetet monetare në arkë e në bankë	16	198,100,061	310,295,447
Totali i aktiveve afatshkurtra		598,381,163	641,329,144
Totali i aktiveve		1,211,561,829	1,329,500,211
KAPITALI			
Kapitali themeltar		148,963,500	148,963,500
Rezerva ligjore		13,378,279	7,306,672
Fitime të mbartura		115,360,536	-
Fitimi i ushtrimit		179,876,861	121,432,143
Totali i kapitalit	17	457,579,176	277,702,315
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë nga ortakut	18	55,721,974	54,852,585
Detyrime për qera financiare	19	302,375,418	319,041,867
Totali i detyrimeve afatgjatë		358,097,392	373,894,452
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	20	75,305,936	76,046,034
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	21	138,928,808	458,784,760
Parapagimet e arkëtuara	22	57,830	83,212
Detyrime tatimore	23	41,830,255	31,918,900
Detyrime për tatim fitimin	33	8,313,194	-
Detyrime për qera financiare	19	103,275,005	99,954,059
Llogari të pagueshme të tjera	24	28,174,233	11,116,479
Totali i detyrimeve afatshkurtra		395,885,261	677,903,444
Totali i detyrimeve		753,982,653	1,051,797,896
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,211,561,829	1,329,500,211

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	25	3,050,176,396	2,573,157,191
Të ardhura të tjera	26	3,792,547	5,829,187
Total të ardhura		3,053,968,943	2,578,986,378
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	27	(2,256,014,157)	(1,915,036,461)
Shpenzime personeli	28	(181,912,780)	(141,069,195)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	29	(175,595,677)	(174,450,584)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	30	(202,166,812)	(188,140,672)
Total shpenzime		(2,815,689,426)	(2,418,696,912)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	31	(18,926,679)	(18,489,563)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	32	(5,940,059)	2,022,332
Fitimi para tatimit		213,412,779	143,822,235
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	33	(33,535,918)	(22,390,092)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(33,535,918)	(22,390,092)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë			
Fitimi i vitit		179,876,861	121,432,143
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		179,876,861	121,432,143


Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	148,963,500	2,974,975	21,765,887	86,633,938	260,338,300
Fitimi i vitit				121,432,143	121,432,143
Dividende të shpërndara			(21,765,887)	(82,302,241)	(104,068,128)
Transferim në rezervë ligjore		4,331,697		(4,331,697)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	148,963,500	7,306,672	-	121,432,143	277,702,315
Fitimi i vitit				179,876,861	179,876,861
Transferim në fitime të mbartura			115,360,536	(115,360,536)	-
Transferim në rezervë ligjore		6,071,607		(6,071,607)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	148,963,500	13,378,279	115,360,536	179,876,861	457,579,176

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më _____ qershor 2021 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Znj. Artenida Dule

Përgatitëse e pasqyrave financiare


Z. Alessandro Rosa
Administrator



Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	213,412,779	143,822,235
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizimi	155,044,797	149,295,168
Rimarrje kuotash nga investime në ndërtime të marra me qera	19,160,551	20,061,474
Zhvlerësimi	1,390,328	5,093,942
Shpenzime për interesa	(18,938,083)	18,502,414
Vlera kontabel neto e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi	-	16,553,587
Ndryshimi në kapitalin qarkullues:		
Rënie/(rritje) në inventar	(11,171,389)	(2,009,126)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(60,257,809)	7,948,387
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	(293,626,941)	131,080,207
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(25,382)	9,649
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(2,271,327)	1,584,411
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	2,717,524	491,942,348
Interesa të paguara	18,938,083	(18,502,414)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(24,837,023)	(31,571,297)
	(5,898,940)	(50,073,711)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(7,458,596)	(60,109,181)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(7,458,596)	(60,109,181)
Aktivitetet financuese		
Dividendi paguar	-	(104,068,128)
Te hyrat/(ripagim) neto në hua afatshkurtra	869,389	(8,768,383)
Shtesa/pakesime në qera financiare	(102,424,763)	(94,714,926)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(101,555,374)	(207,551,437)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(112,195,386)	174,208,019
Mjetet monetare në fillim të periudhës	310,295,447	136,087,428
Mjetet monetare në fund të periudhës	198,100,061	310,295,447

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 36, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "CONAD FOOD TRADE" është regjistruar me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë datë 03/04/2006. NIPT-i shoqërisë është K61704029H.

Shoqëria ka si objekt menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, ndërtimin, dhënien me qira ose në menaxhim, sikurse edhe shitjen e aktiviteteve tregtare me shumicë apo me pakicë dhe të veprave, strukturave që kanë lidhje me keto aktivitete; ndërtimin, menaxhimin dhe shitjen e dyqaneve për shitje të mallrave me shumicë ose pakicë, për llogari të vet apo të të tretëve; blerjen e mallrave ushqimore të përgjithshme, në bashkëpunim me shoqëri dhe entitete të tjera, si dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme që do të jenë objekt i aktivitetit tregtar.

Më datë 07.03.2019 shoqëria vendosi të ndryshojë emrin nga FOOD TRADE shpk në CONAD FOOD TRADE shpk.

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 148,963,500 lekë i cili zotërohet nga ortakët e Shoqërisë:

1. Luan Leka zotëron 88% të kapitalit ose 131,087,880 lekë.
2. Conad Adriatico Societa Cooperativa zotëron 12% të kapitalit ose 17,875,620 lekë.

Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në autostradën Tiranë-Durrës, km. 6 Kashar, Tiranë. Administratori i Shoqërisë është z. Alessandro Rosa.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 234 punonjës (2019: 233). Numri i punonjësve i ndarë sipas kategorive është si më poshtë:

- 1 Administrator
- 4 punonjës administrate
- 229 punonjës të Departamentit të Shitjes

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Përkufizimi i një biznesi (Amendime në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialitetit (Amendime në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Standarde të Ndryshme)
- Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

3.2 Standardet dhe interpretime të lëshuara, por që ende nuk janë adoptuar.

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2020:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/ Lek	100.84	108.64

4.2 Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

- **Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.
- **Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).
- **Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumenta financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)**4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negocohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Qiraja financiare ndahet në afatshkurtër dhe afatgjatë si më poshtë:

Detyrimi për qeratë në pasqyrën e pozicionit financiar	31 dhjetor 2020
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	103,275,005
Detyrimet afatgjata të qirasë	302,375,418
	405,650,423

4.5 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16) (vazhdim)

<i>Shuma të njohura në të ardhura dhe shpenzime</i>	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime amortizimi të aktiveve me të drejta në përdorim	112,465,940
Shpenzimet e interesit (të përfshira në koston e financimit)	(18,937,663)
Shpenzime qeraje që lidhen me qira afatshkurtra	8,464,510
Shpenzime që lidhen me qiradhëniet e aktiveve me vlerë të ulët	-
Shpenzime në lidhje me pagesat e qerasë së ndryshueshme që nuk përfshihen në detyrimet e qerasë	30,860,319
	132,853,106

Tabela e mëposhtme paraqet maturimin e angazhimeve të qerasë operacionale në detyrimin e njohur:

Analiza e maturiteteve të flukseve të paskontuara

	31 dhjetor 2020
Deri në një vit	119,560,080
1 - 5 vite	285,321,429
Mbi 5 vite	16,761,230
Detyrimi i qerasë i paskontuar më 31 dhjetor	421,642,739

4.7. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.8. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatuashem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.15. Krahasueshmeria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.



5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumatat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare.

Llogarite e arketueshme të kompanisë përfshijnë vetëm një dalje të mjeteve monetare, pagesën e vlerësuar që rezultojnë nga transaksioni në lidhje me SNRF 15, i cili konsiderohet të jetë kryesor. Prandaj, daljet e mjeteve monetare nga llogarite e arketueshme janë në përputhje me modelin e biznesit pavarësisht komponentit të interesit duke qenë zero.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.



6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Mjete transporti	Mobilje e pajisje zyre	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2019	17,600,703	485,067,629	502,668,332
Shtesa	161,040	59,648,416	59,809,456
Transferime			-
Pakësime	(28,564)	(31,879,666)	(31,908,230)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	17,733,179	512,836,379	530,569,558
Shtesa	2,072,166	5,386,430	7,458,596
Transferime			-
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	19,805,345	518,222,809	538,028,154
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2019	11,688,893	289,683,798	301,372,691
Amortizimi i vitit	1,182,444	41,930,986	43,113,430
Pakësime	(13,679)	(15,340,964)	(15,354,643)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	12,857,658	316,273,820	329,131,478
Amortizimi i vitit	1,200,359	40,506,680	41,707,039
Pakësime			-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	14,058,017	356,780,500	370,838,517
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	4,875,521	196,562,559	201,438,080
Gjendja më 31 dhjetor 2020	5,747,328	161,442,309	167,189,637

7. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	131,776,751	131,776,751
Shtesa	299,725	299,725
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	132,076,476	132,076,476
Shtesa	-	-
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	132,076,476	132,076,476
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2019	124,189,262	124,189,262
Amortizimi i vitit	7,015,396	7,015,396
Kthim amortizimi		-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	131,204,658	131,204,658
Amortizimi i vitit	871,818	871,818
Kthim amortizimi		-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	132,076,476	132,076,476
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	871,818	871,818
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	-	-

8. Aktive me të drejtë përdorimi

Aktivet me të drejtë përdorimi paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Ndërtesa	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	-	-
Shtesa	513,710,852	513,710,852
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	513,710,852	513,710,852
Shtesa	89,079,260	89,079,260
Gjendja më 31 dhjetor 2020	602,790,112	602,790,112
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2019	-	-
Amortizimi i vitit	99,166,342	99,166,342
Gjendja më 31 dhjetor 2019	99,166,342	99,166,342
Amortizimi i vitit	112,465,940	112,465,940
Gjendja më 31 dhjetor 2020	211,632,282	211,632,282
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	414,544,510	414,544,510
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	391,157,830	391,157,830

9. Parapagime afatgjata

Parapagimet afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Garanci për ambientet e marra me qira	12,096,177	12,096,177
	<u>12,096,177</u>	<u>12,096,177</u>

10. Investime në ambiente të marra me qira

Investimet në ambientet e marra me qira detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Investime në ambiente të marra me qira	42,737,022	59,220,482
	<u>42,737,022</u>	<u>59,220,482</u>

Vlera e investimeve të kryera në ambiente të marra me qira, amortizohet mbi bazën e kohëzgjatjes së kontratës.

11. Inventarë

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mallra	261,658,122	250,486,733
Inventar i imët	10,187,884	10,187,884
Zhvlerësimi inventarit imët	(10,187,884)	(8,797,556)
	<u>261,658,122</u>	<u>251,877,061</u>

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarëve

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendja më 1 janar	(8,797,556)	(3,703,614)
Rimarrje për vitin	-	-
Zhvlerësimi për vitin	(1,390,328)	(5,093,942)
Gjendja më 31 dhjetor	<u>(10,187,884)</u>	<u>(8,797,556)</u>

12. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	21,551,656	21,471,957
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(572,596)	(572,596)
	<u><u>20,979,060</u></u>	<u><u>20,899,361</u></u>

13. Llogari të arkëtueshme nga palë të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Conad Albania sh.p.k	87,384,291	40,493,136
	<u><u>87,384,291</u></u>	<u><u>40,493,136</u></u>

14. Llogaritë të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura të konstatuara	3,500,066	-
Të tjera të arkëtueshme	18,713,427	11,603,629
	<u><u>22,213,493</u></u>	<u><u>11,603,629</u></u>

15. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime	5,977,840	2,704,511
Shpenzime të shtyra për tu shpërndarë në disa periudha	2,068,296	3,070,298
	<u><u>8,046,136</u></u>	<u><u>5,774,809</u></u>

16. Mjete monetare në arkë e në bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	139,378,436	261,289,017
Në Lekë	108,105,522	152,090,295
Në monedhë	31,272,914	109,198,722
Mjete monetare në arkë	58,721,625	49,006,430
Në Lekë	58,695,215	48,931,724
Në monedhë	26,410	74,706
	<u>198,100,061</u>	<u>310,295,447</u>

17. Kapitali

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kapitali i shoqërisë është 148,963,500 lekë.		
Luan Leka	131,087,880	131,087,880
Conad Adriatico Societa Cooperativa	17,875,620	17,875,620
	<u>148,963,500</u>	<u>148,963,500</u>

Rezerva ligjore

Rezervat ligjore të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 kanë qenë në vlerën 13,378,279 Lekë (2019: 7,306,672 Lekë).

Fitim/(Humbje) të mbartura

Shuma prej 115,360,536 Lekë përfaqëson fitimin e mbartur nga viti parardhës (2019: 0 Lek) përfaqëson fitimin e mbartur nga viti parardhës).

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 179,876,861 Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit përgjatë vitit 2020 (2019: 121,432,143 Lekë).

18. Hua afatgjatë nga ortakët

Huaja afatgjatë nga ortakët përbëhet më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua nga ortakët	55,721,974	54,852,585
	<u>55,721,974</u>	<u>54,852,585</u>

19. Detyrime per qira financiare

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrimi afatshkurtër për qeranë financiare	103,275,005	99,954,059
Detyrimi afatgjatë për qeranë financiare	302,375,418	319,041,867
	<u>405,650,423</u>	<u>418,995,926</u>

20. Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme tregtare	66,891,891	70,342,714
Furnitorë për fatura të pambërritura	8,414,045	5,703,320
	<u>75,305,936</u>	<u>76,046,034</u>

21. Llogari të pagueshme nga palët të lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
E.H.W sh.p.k	7,926,628	7,406,254
Conad Albania sh.p.k	46,748,624	355,635,828
Detyrime për dividendë ndaj ortakut Z.Luan Leka	84,253,556	84,253,557
Detyrime për dividendë ndaj ortakut Conad Adriatico Societa Cooperativa	-	11,489,121
	<u>138,928,808</u>	<u>458,784,760</u>

22. Parapagimet e arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime nga klientë	57,830	83,212
	<u>57,830</u>	<u>83,212</u>

23. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,968,242	2,966,257
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,193,040	1,103,771
Tatim në burim	763,293	1,089,725
TVSH për t'u paguar	36,905,680	26,759,147
	<u>41,830,255</u>	<u>31,918,900</u>

24. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga të pagueshme	11,394,554	10,798,212
Të tjera të pagueshme	16,779,679	318,267
	<u>28,174,233</u>	<u>11,116,479</u>

25. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	3,009,009,861	2,537,672,974
Të ardhura nga qeraja	41,166,535	35,484,217
	<u>3,050,176,396</u>	<u>2,573,157,191</u>

26. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura të tjera	3,792,547	5,829,187
	<u>3,792,547</u>	<u>5,829,187</u>

27. Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqitet kostoja e mallrave të shitur që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Kostoja e mallrave të shitur paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Mallra	2,267,185,546	1,917,018,620
Ndryshim gjendje inventari	(11,171,389)	(1,982,159)
	<u>2,256,014,157</u>	<u>1,915,036,461</u>

28. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime paga	161,359,668	122,839,815
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	20,553,112	18,229,380
	<u>181,912,780</u>	<u>141,069,195</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 234 punonjës (2019: 233 punonjës).

29. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime amortizimi	42,578,858	50,128,826
Shpenzime rimarrje kuotash investimi në ambiente me qira	19,160,551	20,061,474
Shpenzime zhvlerësimi inventari/ aktivesh financiare	1,390,328	5,093,942
Shpenzime amortizimi asete në përdorim (SNRF 16)	112,465,940	99,166,342
	<u>175,595,677</u>	<u>174,450,584</u>

30. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje energji, avull, ujë karburant	34,501,334	35,099,963
Shpenzime transporti personeli e të tjera	21,076,930	16,916,764
Mirëmbajtje dhe riparime	16,977,879	15,291,899
Sigurime	12,608,427	12,812,465
Udhëtime e dieta	24,000	96,551
Shpenzime administrative	35,351,088	38,505,864
Qera	42,510,263	37,668,582
Shpenzime ligjore e konsulenca	3,610,093	1,519,062
Lëndë djegëse	2,950,614	865,475
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	977,144	997,279
Komisione dhe tarifa bankare	5,935,855	4,217,856
Tatime dhe taksa të tjera	6,855,233	7,066,442
Gjoha e dëmshpërblime	167,511	1,266,860
Të tjera shpenzime	16,841,208	14,130,718
Uniformat e punonjësve	1,779,233	623,750
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjate	-	1,061,142
	202,166,812	188,140,672

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka njohur shpenzime të auditimit ligjor në vlerën 1,010,093 Lekë pa TVSH.

31. Shpenzime dhe të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet dhe të ardhurat nga interesit dhe të ngjashme (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime për interesa hua	(420)	(15,994)
Të ardhura nga interesat	11,404	12,851
Interesa qira financiare	(18,937,663)	(18,486,420)
	(18,926,679)	(18,489,563)

32. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Fitim dhe Humbjet nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime nga këmbimet valutore	6,490,245	(4,479,967)
Të ardhura nga këmbimet valutore	(550,186)	6,502,299
	<u>5,940,059</u>	<u>2,022,332</u>

33. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	213,412,779	143,822,235
Total shpenzime të panjohura	<u>10,160,006</u>	<u>5,445,045</u>
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	167,511	1,266,860
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	-	-
Interesa SNRF 16 (Qira financiare)	9,705,672	2,603,279
Vlera kontabël e aktiveve afatgjata të shitura	-	1,061,142
Shpenzime të tjera të pazbritshme	286,823	513,764
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>223,572,785</u>	<u>149,267,280</u>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	33,535,918	22,390,092
	<u>179,876,861</u>	<u>121,432,143</u>

34. Palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet e mëposhtme vijnë nga aktiviteti i përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
CONAD ALBANIA shpk	87,384,291	46,748,624	40,493,136	355,635,828
EHW GMBH	-	7,926,628	-	7,406,254
Dividend L.Leka	-	84,253,556	-	84,253,557
Dividend Conad Adriatico	-	-	-	11,489,121
	87,384,291	138,928,808	40,493,136	458,784,760

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Conad Albania shpk	83,684,115	2,083,009,485	67,125,230	1,746,858,763
EHW GMBH	1,710,942	38,267,053	1,492,479	31,256,499
Qafshatama shpk	3,825	105,673	36,082	
	85,398,882	2,121,382,211	68,653,791	1,778,115,262

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti i përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe çmime të përafërta me ato të tregut.

Përveç përfitimeve afatshkurtra ndaj ekipit manaxhues të Shoqërisë, në shumën 1,659,588 Lekë nuk janë dhënë kompensime të tjera ndaj menaxhimit.

35. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

35. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i normave te interesit**

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë, për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve, që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat, institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 dhjetor 2020				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	130,576,844				130,576,844
Mjete monetare në arkë dhe bankë	198,100,061				198,100,061
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2020	328,676,905	-	-	-	328,676,905

Përshkrimi	31 dhjetor 2019				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	72,996,126				72,996,126
Mjete monetare në arkë dhe bankë	310,295,447				310,295,447
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2019	383,291,573	-	-	-	383,291,573

35. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë, pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do t'i duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor, që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilin e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

31 dhjetor 2020

Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	130,576,844				130,576,844
Mjete monetare në arkë dhe bankë	198,100,061				198,100,061
Totali	328,676,905	-	-	-	328,676,905
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(284,239,232)				(284,239,232)
Hua	(56,801,253)	(46,473,752)	(343,871,526)	(14,225,866)	(461,372,397)
Totali	(341,040,485)	(46,473,752)	(343,871,526)	(14,225,866)	(745,611,629)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2020	(12,363,580)	(46,473,752)	(343,871,526)	(14,225,866)	(416,934,724)

31 dhjetor 2019

Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	72,996,126				72,996,126
Mjete monetare në arkë dhe bankë	310,295,447				310,295,447
Totali	383,291,573	-	-	-	383,291,573
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(577,866,173)				(577,866,173)
Hua	(54,974,732)	(44,979,327)	(359,668,586)	(14,225,866)	(473,848,511)
Totali	(632,840,905)	(44,979,327)	(359,668,586)	(14,225,866)	(1,051,714,684)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	(249,549,332)	(44,979,327)	(359,668,586)	(14,225,866)	(668,423,111)

35. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i monedhës**

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2020			
	EUR	LEK	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera		130,576,844		130,576,844
Mjete monetare në arkë dhe bankë	31,299,324	166,800,737		198,100,061
Totali	31,299,324	297,377,581	-	328,676,905
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera		(284,239,232)		(284,239,232)
Hua	(416,689,958)	(44,682,439)		(461,372,397)
Totali	(416,689,958)	(328,921,671)	-	(745,611,629)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2020	(385,390,634)	(31,544,090)	-	(416,934,724)

Përshkrimi	31 dhjetor 2019			
	EUR	LEK	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	72,996,126		72,996,126
Mjete monetare në arkë dhe bankë	109,273,428	201,022,019		310,295,447
Totali	109,273,428	274,018,145	-	383,291,573
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera		(577,866,173)		(577,866,173)
Hua	(429,166,072)	(44,682,439)		(473,848,511)
Totali	(429,166,072)	(622,548,612)	-	(1,051,714,684)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019	(319,892,644)	(348,530,467)	-	(668,423,111)

36. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të Shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

37. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

38. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

39. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

